

VENDIM
Nr. 198, datë 3.4.2024

PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore. Këshilli Kombëtar i Ujit kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- ministrin përgjegjës për mjedisin dhe turizmin;
- ministrin përgjegjës për bujqësinë;
- ministrin përgjegjës për infrastrukturën;
- ministrin përgjegjës për financat;
- ministrin përgjegjës për ekonominë;
- ministrin përgjegjës për mbrojtjen;
- ministrin përgjegjës për shëndetësinë.

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme, Kryeministri nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë mbledhja kryesohet nga zëvendëskryeministri.

3. Vendimi nr. 590, datë 18.10.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Ujit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Ujit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama